

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK), Shkurt 2025

10.03.2025

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit (IHÇK) për muajin Shkurt 2025, viti bazë 2015=100.

Çmimet e konsumit shkuan në 1,7% vjetore dhe 0,4% mujore

Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë në një mesatare prej 1,7% në muajin shkurt 2025, krahasuar me muajin shkurt 2024. Inflacioni mujor ishte 0,4% në muajin shkurt 2025.

Shkurt 2025 / Shkurt 2024 1,7 %

Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë në një mesatare prej 1,7% në muajin Shkurt 2025 krahasuar me muajin Shkurt 2024. Kjo kryesisht është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të konsumit në këtë periudhë të grupet dhe nëngrupet e COICOP-it: kafja, çaji dhe kakao (14,9%), vajrat dhe yndyrnat (9,8%), shërbime të tjera në lidhje me pajisjet personale të transportit (7,6%), gazetatat, librat dhe materialet për zyra (6,2%), mishi (5,6%), uji mineral, pijet joalkoolike, lëngjet nga pemët dhe perimet (5,5%), shërbimet financiare (5,2%), qumështi, djathi dhe vezët (4,6%), pijet alkoolike (4,1%), veshje (3,6%), %, mallrat dhe shërbimet për mirëmbajtjen e zakonshme të ekonomisë shtëpiake (3,5%), kujdesi personal (3,3%), shërbimet hoteliere (3,2%), duhani (2,9%), qelqurinat, takëmet dhe mjetet e kuzhinës (2,8%), pajisje shtëpiake (2,5%), perimet (2,4%), buka dhe drithërat (1,8%), shërbimet ambulatore (1,8%), sheqeri, reçeli, mjalta, çokollata dhe ëmbëlsirat (1,6%) dhe pemët (1,4%) me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 2,4 për qind në IHÇK-it.

Ndërsa rënie e çmimeve vërehet te grupi i COICOP-it: lëndët djegëse të ngurta, dru zjarri, pelet etj. (-6,0%), biletat e fluturimeve (-5,5%), karburantet dhe lubrifikantët për pajisjet e transportit personal (-5,1%) dhe blerja e automjeteve (-1,9%) dhe blerja e automjeteve (-1,6%) me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej -0,7 për qind në IHÇK-it.


Shkurt 2025 / Janar 2024 0,4 %

Indeksi i tërësishëm i harmonizuar i çmimeve të konsumit është më i lartë në një mesatare prej 0,4% në muajin Shkurt 2025 krahasuar me muajin Janar 2025. Kjo kryesisht është shpjeguar me ngritjen e çmimeve të konsumit në këtë periudhë të grupet dhe nëngrupet e COICOP-it: pemët (3,3%), kafja, çaji dhe kakao (2,3%), perimet (2,1%), karburantet dhe lubrifikantët për pajisjet e transportit personal (1,8%), lëndët djegëse të ngurta, dru zjarri, pelet etj. (1,7%), shërbimet ambulatore (1,1%), shërbimet hoteliere (1,1%), mallrat dhe shërbimet për mirëmbajtjen e zakonshme të ekonomisë shtëpiake

(1,0%), ndryshimet e çmimeve të produkteve dhe shërbimeve të disa nëngrupeve me një ndikim të vogël në IHÇK-it. me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 0,7 për qind në IHÇK-it.

Ndërsa rënie e çmimeve vërehet te grupi i COICOP-it: biletat e fluturimeve (-11,4%) dhe energjia elektrike (-3,8%) me një ndikim të përbashkët të këtyre nëngrupeve prej 0,3 për qind në IHÇK-it.

Norma mujore dhe vjetore e inflacionit në % të matura nga IHÇK



Ndryshimet mujore dhe vjetore të çmimeve në % për grupe dhe nëngrupe të COICOP-it

COICOP	Grupet dhe nëngrupet	Peshat 2024 në %	II - 2025 2015=100	II - 2025 I - 2025	II - 2025 II - 2024
00	Gjithsej IHÇK	1000.0	132.6	0.4	1.7
01	Ushqimi dhe pijet joalkoolike	351.1	151.5	0.9	4.4
02	Pijet alkoolike, duhani	67.6	144.3	0.2	3.4
03	Veshje dhe këpucë	40.6	110.3	0.2	3.0
04	Strehimi , uji, energji elektrike, gazi dhe lëndë djegëse të tjera	89.8	126.2	-0.3	-1.6
05	Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	63.0	124.5	0.4	2.3
06	Shëndetësia	22.8	118.4	0.8	1.9
07	Transporti	176.7	118.6	-0.2	-2.7
08	Mjetet e komunikimit	23.7	112.5	0.1	-1.8
09	Rekracioni dhe kultura	44.5	107.8	0.3	1.3
10	Arsimi	6.9	106.5	0.0	2.4
11	Restorantet dhe hotelet	40.8	133.5	1.0	3.1
12	Mallrat dhe shërbimet e ndryshme	72.2	121.7	0.3	2.4

Për më shumë informata, lidhur me publikimin e Indeksit të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit (IHÇK) për muajin shkurt 2025, vizitoni: <https://ask.rks-gov.net/Themes/PricesAndInflation>

